



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË

Shpallja e procedurës së aplikimit për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm) për vitin akademik 2024 – 2025.

Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, shpall procedurën e aplikimit për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm) për vitin akademik 2024 – 2025, për:

**Departamentin Ekonomiks, Departamentin Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar,
Departamentin Manaxhim, Departamentin Financë, Departamentin Kontabilitet dhe
Departamentin Marketing – Turizëm.**

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët që do të konkurrojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm), janë si më poshtë:

Kritere të përgjithshme:

1. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.
2. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës, për kryerjen e një vepre penale me dashje.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të zotërojnë së paku diplomën në Master i Shkencave ose DIND në Fakultetin e Ekonomisë UT, ose në fusha të ngjashme me to në Universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, me rezultate të larta.
2. Preferohen të kenë eksperiencë në mësimdhënie pranë Fakultetit të Ekonomisë UT.
3. Të zotërojnë me dëshmi një gjuhë të huaj, të vendeve të BE-së.
4. Preferohen aplikantët që kanë aftësi të mira komunikuese.

Shënim: Kandidatët që kanë qënë të miratuar si personel akademik me kohë të pjesshme (pedagogë të jashtëm) për vitin akademik 2023 – 2024, duhet të paraqesin, vetëm kërkesën për vijimësinë e tyre pranë Departamenteve ku kanë qënë të angazhuar.

Kandidatët konkurrentë duhet të paraqesin këtë dokumentacion:

Kërkesë.

Curriculum Vitae e përditësuar (në gjuhën zyrtare shqip).

Fotokopje e dokumentit të identitetit (kartë identiteti ose pasaportë).

Diplomë e studimeve universitare Bachelor dhe Master i Shkencave. Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet dokumenti i njohjes së diplomës.

Listë notash Bachelor dhe Master i Shkencave. Dokumenti i njohjes së listës së notave për ata që kanë mbaruar në universitetet e huaja.

Dokumenti i laureimit me grade apo titull akademik. Dokumenti i njohjes së grades apo titullit akademik.

Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj.

Çertifikatë personale.

Dëshmi e mbrojtjes së gjuhëve të huaja.

Vertetim nga qendra e punës e muajit të fundit.

Dëshmi penaliteti.

Libreza shëndetësore.

Raport për aftësi në punë.

Dokumentacioni dorëzohet pranë departamentit përkatës ku do të aplikohet, në Fakultetin e Ekonomisë Universiteti i Tiranës. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri në datën 07.10.2024, ora 12.00.